URDHËR
Nr. 498, datë 31.12.2024

PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË AUTORIZIMIT PËR IMPORTIN E HIDROFLUOROKARBONEVE DHE/OSE PAJISJEVE TË PARAMBUSHURA ME HIDROFLUOROKARBONE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 20, të kreut VI, të ligjit nr. 2/2023, "Për gazet serrë të fluoruara".

URDHËROJ:

Miratimin e formatit të autorizimit për importin e hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur dhe që është pjesë e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

Shtojca 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

MINISTRI

Nr. _____ Prot. Datë ____._____.202_

AUTORIZIM

PËR PAJISJE ME KUOTË IMPORTI I HIDROFLUOROKARBONEVE DHE/OSE PAJISJEVE TË PARAMBUSHURA ME HIDROFLUOROKARBONE

Mbështetur në pikën 4, të nenit 20, të Kreut VI, të ligjit nr. 2/2023, "Për gazet serrë të fluoruara" dhe në zbatim të Vendimit Nr. 707, datë 14.112024 të Këshillit të Ministrave "Për kushtet e posaçme, dokumentacionin shoqërues, procedurën, afatet për dhënien e autorizimit, si dhe për mënyrën dhe kriteret e ndarjes së kuotave vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone" miratohet ky autorizim për pajisjen me kuotë importi të hidrofluorkarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone, **për [emri i sipërmarrësit],** me të dhënat si më poshtë:

1. **Nr. Autorizimit:** [*numri autorizimit*]
2. **Të dhënat mbi sipërmarrësin:**
   Emri i personit fizik/juridik: [*emri i sipërmarrësit*]
   NUIS: [*numri NUIS*]
   Licenca: [*numri i licencës*]
   Adresa: [*adresa e sipërmarrësit*]
   Kontakt: [*nr. telefoni/e-mail*]
   Emri i Drejtuesit Teknik: [*Emër, Mbiemër*],
3. **Sasia e përcaktuar e kuotës së importit**: _____ Ton CO_2 ekuivalent,

Autorzimi për pajisje me kuotë importi hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone është i vlefshëm nga data e miratimit të tij deri në 31 dhjetor të vitit aktual.
Sipërmarrësi mban përgjegjësitë ligjore të parashikuara në ligjin nr. 2/2023, "Për gazet serrë të fluoruara" për importin e hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone për të cilat lëshohet ky autorizim.

_____

MINISTËR